



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA

KPPP.nr.171/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për çështje Ekonomike, gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen përmbartimore të kreditorit: N.T.Sh “E...” me seli në Glllogoc me përfaqësues Sh.B. nga fshati Komuna e Glllogocit të cilin me autorizim e përfaqëson Avokati Halim Kuliqi nga Glllogoci, kundër debitorit: Ujësjiellësi Rajonal “ Prishtina ” me seli në Prishtinë, që ka të bëjë me pagesën e borxhit, si objekt i përmbartimit, duke vendosur sipas prapësimit të debitorit të ushtruar kundër Urdhrit përmbartimor të lejuar nga Përmbartuesi Privat P.nr.08/2019 të dt:10.01.2019, mbi caktimin e përmbartimit, me dt:13.10.2022, jashtë seance merr këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET SI I PABAZUAR prapësimi i debitorit Ujësjiellësi Rajonal “ Prishtina ” me seli në Prishtinë, i ushtruar kundër Urdhrit për lejimin e përmbartimit numër P.nr.08/2019 të dt:10.01.2019, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Fadil Hoxha.

A r s y e t i m

Përmbartuesi privat në territorin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit për përmbartim të kreditorit ka lëshuar urdhër me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti Ekonomik III.C.nr.500/2013 datë 25.02.2016, i cili është dokument përmbartues në bazë të nenit 21 dhe 22 të LPP-së.

Kundër urdhrit për lejimin e përmbartimit, brenda afatit ligjor, debitori ka paraqitur prapësim, me të cilin konsideron se urdhri përmbartimorë është i pa rregullt dhe pa efekte juridik sepse Ligji dhe Udhëzimi Administrativ nuk e njohin si urdhër përmbartues asnjë ngjyrosja apo vizatimin në shkresat e kreditorit, por vetëm urdhrin si aktin juridik i përpiluar me të gjitha elementet në përputhje me dispozitat ligjor në fuqi. Po ashtu debitori i përmbartimit kishte theksuar se dokumentin mbi bazën e të cilit është lejuar urdhri përmbartimor i mungon vula e rregullt e cila vërteton formën e prerë dhe ekzekutuesmerinë e aktgjykimit të shkallës së parë, e në këtë kuptim ky dokument është në kundërshtim me nenin 36 pika 1 të LPP-së. Andaj debitori ka kishte propozuar gjykatës që të aprovohet prapësimi dhe urdhri përmbartimor të shfuqizoj apo të hedhet poshtë si pa lejuar.

Kreditori ka paraqitur përgjigje në prapësimin e debitorit, ka theksuar se pretendimet e debitorit janë në kundërshtim me dispozitat ligjore të LPP-së. Po ashtu kishte deklaruar se urdhri përmbartimor është i mbështetur në dy Aktgjykime të dy instancave Gjyqësore dhe titulli

ekzekutiv përmban klauzolën e plotfuqishmërisë dhe përmbarueshmërisë dhe i njëjti duhet të përmbarohet në pajtim me dispozitat e LPP-së, prandaj i ka propozuar Gjykatës që pas administrimit të provave, prapësimin ta refuzojë si të pabazuar dhe të lejohet propozimi për përmbarim.

Gjykata ka vlerësuar Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti Ekonomik III.C.nr.500/2013 datë 25.02.2016, në bazë të të cilit përmbaruesi privat ka zbatuar përmbarimin, i cili dokument përmbarues përbën bazë juridike për caktimin e përmbarimit, ngase i ka plotësuar kushtet ligjore nga nenit 21,22 dhe 27 i LPP-së, për të qenë i përmbarueshem dhe njëkohësisht i përshtatshëm për përmbarim.

Gjykata, bëri shiqimin e shkresave të lëndës, analizoi pretendimet e debitorit në prapësim, dhe vlerësoi se janë të paqëndrueshme dhe të pabazuara në ligj, për arsye se nuk ka ofruar prova në mbështetje të pretendimeve të tij siç është paraparë me nenin 69 par. 4 të LPP-së, se nuk janë përmbushur asnjë nga kushtet ligjore për anulimin e Urdhrit të Përmbaruesit Privat apo shtyrjen e zbatimit të përmbarimit, të përcaktuara me dispozitat e nenit 61 par 1 pika 1 dhe nenit 71 par 1, pika 1 deri në 12 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore (Ligji nr. 04/L-139), të Republikës së Kosovës.

Nga arsyet e paraqitura, në bazë të nenit 73 të LPP-së, kjo gjykatë gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe të njëjtin e refuzoj.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.171/22, dt.13.10.2022

Gj y q t a r i
Alajdin Tërshnjaku

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej 7 ditësh nga marrja e të njëjti, përmes kësaj gjykate për Dhomat e Shkallës së dytë të Gjykatës Komerciale të Kosovës me seli në Prishtinë.